



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Pzd.nr104/2024

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët: Agim Maliqi, kryetar i kolegji, Mejreme Memaj dhe Rasim Rasimi, anëtarë, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtorit profesional Bujar Balaj, procesmbajtës, në çështjen penale ndaj të dënuarit A. (H.) S., nga fshati Zh. i E., komuna e M., tani me vendqëndrimi në H., rruga "H.", nr..., F., për shkak të veprës penale rrezikimi i trafikut publik nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës (KPRK), duke vendosur përkitazi me kërkesën e të dënuarit për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 10.10.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

Refuzohet si e pabazuar kërkesa e të dënuarit A. S., për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, shqiptuar me aktgjykimin e formës së prerë të Gjykatës Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm P.nr.28/2023 të datës 14.09.2023.

A r s y e t i m i

Gjykata Themelore në Mitrovicë - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin P.nr.28/2023 të datës 14.09.2023 të dënuarin A. S., për veprën penale rrezikimi i trafikut publik, nga neni 370 par.9 lidhur me par.1 të KPRK-së, dhe e ka gjykuar me dënim burgimi në kohëzgjatje prej 8 (tetë) muaj, në të cilin dënim do t'i llogaritet edhe koha e kaluar në paraburgim dhe arrest shtëpiak prej datës 10.12.2022 e deri më datë 10.02.2023.

Në procedurën ankimore, Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin PA1.nr.1487/2023 të datës 26.02.2024, ka refuzuar si të pabazuar ankesën e mbrojtësit të dënuarit, ndërsa ka vërtetuar aktgjykimin e shkallës së parë.

Kërkesë për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit ka paraqitur i dënuari A. S., me propozim që Gjykata Supreme e Kosovës ta aprovojë si të bazuar kërkesën, ta ndryshojë aktgjykimin e formës së prerë lidhur me vendimin mbi dënim dhe lartësinë e dënimit nga 8 muaj në 6 muaj duke ia llogaritur edhe kohën e kaluar në paraburgim.

Prokurori i Shtetit i Kosovës në Prishtinë, me parashtresën KZJD.nr.104/2024 e datës 30.09.2024, ka propozuar që kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit të refuzohet si e pabazuar. Propozim të njëjtë ka dhënë edhe Gjykata Themelore në Mitrovicë, në shkresën P.nr.28/2023, e datës 17.09.2024, si dhe Prokuroria Themelore në Mitrovicë, në mendimin PP.II.nr.2318/2022 e datës 12.09.2024.

Gjykata Supreme e Kosovës, në bazë të nenit 431 par.1 të Kodit të Procedurës Penal (KPP), pasi që shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit, propozimet e lartë cekura, gjeti se:

- kërkesa për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit është e pabazuar.

Me dispozitën e nenit 429 të KPP-së, parashihet se zbutja e jashtëzakonshme e dënimit lejohet nëse pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë, paraqiten rrethanat të cilat nuk kanë ekzistuar në kohën e marrjes së aktgjykimit ose, megjithëse kanë ekzistuar në atë kohë gjykata nuk ka qenë në dijeni për to, kurse ato dukshëm do të ndikonin në dënimin më të ulët.

Gjykata Supreme, në përputhje me këtë dispozitë, vlerëson nëse rrethanat e reja që theksohen në kërkesë do të qonin në caktimin e një dënimi më të butë, po qe se ato do të ekzistonin me rastin e shqiptimit të dënimit në procedurën e rregullt, gjithmonë duke pasur parasysh peshën e veprës penale të kryer.

Në kërkesën e tij i dënuari thekson se, që nga data 21.03.2023 është paisur me vizë pune nga shteti i F. edhe ende është duke punuar në këtë shtet, se i është vazhduar viza e punes ku nga të ardhurat e realizuara kontribon në gjendjen financiare të familjes, andaj propozon që dënimi ti zbutet në 6 gjashtë apo ti zëvendsohen me gjobë. Kërkesës i ka bashkangjitur pasaporten me vizë të Finlandes.

Nga shkresat e lëndës del se gjykatat me rastin e vendosjes lidhur për llojin dhe lartësinë e dënimit kanë vlerësuar rrethanat të cilat kanë ekzistuar në kohën e marrjes së vendimit. Rrethanat në të cilat thirret mbrojtësja në kërkesë nuk janë të asaj natyre që e justifikojnë zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit. Në anën tjetër vuajtja e dënimit për pasojë ka mos mundësinë e përfilljes së disa obligimeve të cilat mund të kryhen kur personi është në liri dhe është pasojë e heqjes së lirisë.

Andaj, rrethanat të cilat cekën në kërkesën për zbutje të jashtëzakonshme të dënimit nuk e kanë karakterin e rrethanave nga dispozita e nenit 429 të KPP-së, të cilat do të ishin bazë për aprovimin e kërkesës.

Nga sa u tha më lartë, kjo gjykatë gjen se nuk janë plotësuar kushte ligjore për aprovimin e kërkesës për zbutjen e jashtëzakonshme të dënimit dhe konform dispozitës së nenit 431 par.7 të KPP-së, vendosi si në dispozitivë të këtij aktvendimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS - PRISHTINË

Pzd.nr.104/2024, më datë 10.10.2024

Bashkëpunëtori profesional,
Bujar Balaj

Kryetari i kolegjit,
Agim Maliqi